



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **52**

Prishtinë, më 7.7.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulfë Merxha, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Berat Luzha, Dragiša Mirić.

Munguan :Zef Morina, Ali Lajçi, Selvie Halimi, Lulzim Zeneli.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Shefki Zeqiri dhe Muzafer Luma nga MBPZHR dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Kujtim Aliu.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet,
3. Përfundimi i Kryesisë rreth shpalljes së Zonës së interesit të veçantë.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës. **Elheme Hetemi** propozoi për pikën të ndryshme : Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë rreth shpalljes së Zonës me Interes të Veçantë ekonomik ku do të ndërtohet Hidrocentrali i Zhurit. **Komisioni miratoi këtë propozim.**

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Pyjet**

**Naim Maloku** shkurtimisht lexoi të dhënat nga seanca plenare e dt. 25 qershor 2009 kur është miratuar ky projektligj dhe pyeti përfaqësuesit e MBPZHR sa i kanë analizuar këto çështje rreth projektligjit në fjalë.

**Elheme Hetemi** tha se nuk është e njoftuar mjaft me këto ndryshime të propozuara mirëpo nga materialet she sugjerimet e deritanishme ishte fillimisht e mendimit se nuk bënë të kaloi APK në kuadër të MMPH përkatësisht Departament Mjedisor apo kudo tjetër.

**Naim Maloku** në emrin e tij personal (jo si kryesues) tha se dilema e tij është neni 12 i projektligjit të propozuar përkatësisht nëse kalon menaxhimi tek komunat kishte me u pajtua, nëse jo atëherë i ka disa rezerva në këtë projekt.

**Elheme Hetemi** tha se mendon ndryshe ngase duhet të mbetet menaxhimi qendror përveç disa kompetencave të cilat duhet të jenë të komunave, megjithatë duhet të dëgjohen palët e interesuara dhe të nxirret përfundimi meritor. Poçes kalojnë kompetencat nga një nivel në një nivel tjetër ashtu pa analiza, brenga është se do të kemi kompetentët joprofesional , përfundoi ajo.

**Naim Maloku** konstatoi se ligji i deritanishëm është katastrofal, çka konstatoi edhe **Heset Cakolli** sepse si tha ai edhe në terren është vërejt një gjë e tillë. Nenin 12 të projektligjit e përkrahu por kërkoi të sqarohet neni 3 ku ceken vetëm pyjet publike por çka me ato private.

**Myrvete Pantina** poashtu vërtetoi konstatimet e parafolësve rreth mungesës së kompetencave nëpër komuna sa i përket Pyjeve, ndaj me arsye kërkojnë mbikëqyrjen e pyjeve, propozoi të dëgjohen zyrtarët e ftuar nga MBPZHR.

**Elheme Hetemi** kërkoi disa sqarime nga kryeshefi i APK rreth kompetencave : a do të mbetet agjencia prapë administruese e pyjeve, dhe nëse ndryshon gjë a do të ndryshojnë kompetencat.

**Berat Luzha** shprehu pakënaqësinë e tij të lart sa i përket Pyjeve sepse pas një viti kur janë kërkuar përmirësimet nga Kuvendi, prapë vjen një projektligj i paqartë dhe aspak shpresëdhënës : nuk ndryshon asgjë ose fare pak ndryshon. Ai tha se neni 12 i projektligjit është imponuar nga pakoja e Ahtisarit por asgjë konkrete, ngase menaxhimi që propozohet në nenin 12 është ngushtë e lidhur me veprimet tjera menaxhuese, çka do të thotë se nuk sqarohet : si do të veprojnë njësitë komunale, kush do ti menaxhoi drejtoritë komunale, çfarë roli do të kenë zyrat regjionale të cilat është deshtë të transferohen në agjenci apo mbeten jashtë ligjit, çka është propozuar me 20%-shin e komunave, këto 15 nene të propozuara janë hajgare sepse ne në fakt duhet të debatojmë vetëm për një nen (12) : kompetencat, ai në fund propozoi të mbahet një dëgjim publik.

**Naim Maloku** falënderoi komisionin për mendimet e dhëna dhe para se të jap fjalën zyrtarëve të MBPZHR kërkoi një orientim të qartë të shqyrtimit të çështjes nga komisioni.

**Shefki Zeqiri** falënderoi për bashkëpunimin e sinqertë nga ky komision dhe theksoi se Qeveria punon sipas parimit të mbrojtjes së pasurive kombëtare me një politikë qendrore e jo me 30 politika komunale. Gjatë diskutimit të z. Shefki, kryesuesi e luti Berat Luzhën mos të ndërhyjë ngase është mirëkuptuar nga komisioni. Z. Shefki vazhdoi duke theksuar se kompetencat do ti barten komunave saktësisht sipas akteve nënligjore dhe kërkoi nga të pranishmit të tregojnë ndonjë shtet të rajonit si shembull ku menaxhimi bëhet nga komunat e jo nga shteti. Ai tha se agjencia do të merët me punë ekzekutive të ministrisë, dhe luti kryeshefin e APK ti sqaroi më mirë kompetencat.

**Muzafer Luma** fillimisht luti të pranishmit mos të përshkohen nga emocionet, ngase ato ndonjëherë dinë të tregojnë rrugën e gabuar. Ky projektligj, tha ai, do të saktësoi shumë qartë çka do të bëjë komuna e çka shteti. Agjencia nuk do të ketë njësi nëpër komuna dhe do të fitoi një karakter të monitorimit duke hartuar planet, sistemin organizativ si dhe do të ketë kompetencën e damkës, ndërkaq komunat do të kenë komplet përgjegjësinë për pyjet, tenderët, licencat etj. Në pyetjen e **Elheme Hetemit** rreth derdhjes së taksave, ai tha se të gjitha të hyrat do të shkojnë në buxhetin e Kosovës p.sh. nëse kontribuon më së tepërmi Deçani ky fakt do të reflektohet qartë në departamentin e thesarit. Edhe në Bruksel, vazhdoi z. Luma, kanë sugjeruar se komunat duhet të kenë kujdese sa kanë kapacitetin për këtë menaxhim.

**Berat Luzha** në paraqitjen e sërishme tha se të gjitha këto që u dëgjuan janë fjalë të cilat duhet të shkruhen në ligj e jo të shkruhet një nen i cili aspak nuk ka garanci se do të zbatohet. Ligji ekzistues është kopje nga Skandinavia dhe nuk i përshtatet realitetit Kosovar dhe nuk ka qasje serioze, të cilin ai vazhdimisht e kërkon që nga viti 2004. Ai në fund tha : “nuk kamë më nerva” dhe e lëshoi mbledhjen.

**Naim Maloku** propozoi, ndërsa komisioni nxori :

### **P Ë R F U N D I M**

1. Më 21.7.2009 në orën 13,00 mbahet dëgjimi publik rreth projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pyje nr. 2003/3.
2. Zyrtarët e MBPZHR deri më datën 16 korrik 2009 duhet të hartojnë sqarimet me shkrim për projektligjin e propozuar të cilat paraprakisht do ti dërgohen anëtarëve të komisionit, të cilat sqarime këta zyrtarë do ti mbrojnë gjatë dëgjimit publik përballë zyrtarëve komunal. Pyetjet për dëgjimin publik do të jenë : 1. Si do të funksionoi Agjencia (APK), 2. Organizimi dhe funksionimi i zyrave regjionale, 3. Çfarë kompetenca do të kenë komunat përkatësisht Drejtoritë Komunale.
3. Të ftohen përfaqësuesit e komunave dhe ministrive të Bujqësisë dhe të Mjedisit.

### **3. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit rreth shpalljes së Zonës me interes të veçantë**

**Naim Maloku** vazhdoi me shqyrtimin e pikës së tretë të shtuar rreth shpalljes së zonës me interes të veçantë ekonomik ku do të ndërtohet Hidrocentrali i Zhurit.

**Elheme Hetemi** tha se nuk do të ishte keq që ky komision bashkërisht me komisionin për Ekonomi e tregti të harmonizojnë qëndrimet dhe të japin pëlqimin e përbashkët për këtë shpallje me interes të veçantë.

**Naim Maloku** tha se ky projekt është një interes i shfaqur qysh para 30 vitesh e cila tani riaktualizohet nga Qeveria dhe Kryesia e Kuvendit, ndërkaq meqë ky komision deri tani nuk ka marr ndonjë reagim (pozitiv apo negativ) nga ndonjë palë e interesuar sa i përket kësaj çështjeje nga zona ku shtrihet ky vend (Prizren-Dragash), propozoi ndërsa komisioni pas përkrahjes edhe nga **Heset Cakolli** nxori këtë :

### **P Ë R F U N D I M**

**I rekomandohet seancës plenare për miratim vendimi i Qeverisë së Kosovës me të cilin i propozohet Kuvendit të Kosovës që të shpallë Zonën e interesit të veçantë ekonomik, hapësirën ku do të ndërtohet “Hidrocentrali Zhur” me një sipërfaqe prej 19.41 km<sup>2</sup>.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10, mbledhja e radhës do të mbahet pas dy dëgjimeve publike.

Kryesuesi i Komisionit,  
**Naim Maloku**